



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:288975

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05524836

KF.nr.704/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit Auto Servis Astriti Sh.P.K. me adresë në fsh. Komoran, Komuna Glllogoc, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat K.K. kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti depo doganore, vlerë kontesti e pa përcaktuar, duke vepruar sipas parashtrësës së paditësit të datës 28.03.2024, me datën 29.03.2024, jashtë seance mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PEZULLOHET procedura në kontestin tregtar-administrativ KF.nr.704/23, sipas padisë së paditësit Auto Servis Astriti Sh.P.K. me adresë në fsh. Komoran, Komuna Glllogoc, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit nr.prot. 01.3.2.2/23583 të datës 14.11.2023, për shkak se paditësi ka hequr dorë nga padia.

**A r s y e t i m**

Paditësi Auto Servis Astriti Sh.P.K. me adresë në fsh. Komoran, Glllogoc, përmes përfaqësuesit të tij, Avokat K.K. ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike: anulim vendimi. Me padi, paditësi ka kundërshtuar vendimin nr. prot. 01.3.2.2/23583 të datës 14.11.2023, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e të njëjtit.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij me parashtrirat e dorëzuara në Gjykatë me datën 28.03.2024, ka kërkuar tërheqjen e padisë me shenjën KF.nr.704/23 të parashtruar nga paditësi pranë kësaj Gjykate kundër të paditurit Dogana e Kosovës, lidhur me çështjen juridike për anulimin e vendimit nr.prot. 01.3.2.2/23583 të datës 14.11.2023.

Duke marrë për bazë faktin se paditësi ka hequr dorë nga padia dhe kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të tij dhe bazuar në dispozitat e nenit 31 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilën thuhet se *“Paditësi mund të heq dorë nga padia derisa të mos merret vendimi”*, gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për ta PEZULLUAR procedurën në këtë kontest tregtar administrativ, komfor nenit 31, paragrafi 1, të Ligjit nr.03/L-202, për Konfliktet Administrative, prandaj Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje sipas padisë.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 31 par.1 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.704/23, datë 29.03.2024

G j y q t a r i

Fisnik NULI

---

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.